



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 10, të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37.2 pika (c), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03L-040, nenin 5, 6 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, Nr.01/2017, si dhe Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, KI45/2020 dhe KI46/20, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 28.12.2021, nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. **Z.Camil Mazrek**, emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Mamushë, nga subjekti politik "Kosova Adalet Turk Partisi", duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal z.Arif Butuc.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet z.Camil Mazrek, dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatim.

## Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 24.12.2021, Nr.3516/2021, për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal z.Arif Butuc, me rastin e dorëheqjes së tij, për arsye personale.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar, se kandidati në listën e rënditur është z.Camil Mazrek.

Kandidati i radhës ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit si kandidat i radhës, nga i njëjti subjekt politik, i gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, duke mos tejkalluar kuotën prej 30 % , të kufirit minimal të përfaqësimit gjinor të gjinisë pakicë, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2021. Andaj, pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 28.12.2021

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

